



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Nr 72 Prot

Tiranë, më 8.1 2015

**URDHËR**

Nr. 6 datë 07-01 2015

**PËR**

**MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ZBATIMIN E SKEMËS SË HEMOVIGJILENCËS”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenit 15 dhe 25 të ligjit nr.9739, datë 21.05.2007 “Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rekomandimeve të Komitetit Kombëtar të Gjakut,

**URDHËROJ**

1. Miratimin e rregullores “Për zbatimin e skemës së hemovigjilencës”.
2. Ngarkohen Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, Bakat e gjakut në spitale, Drejtoritë e Spitaleve Universitare, Drejtoritë e Spitaleve Rajonale, Drejtoritë e Spitaleve në rrethe dhe spitalet jo publike, për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohen Drejtoria e Administrimit Spitalor në Ministrinë e Shëndetësisë, Instituti i Shëndetit Publik dhe Inspektorati Shëndetësor Shtetëror për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.
4. Urdhri nr. 152, datë 14.04.2008 Për miratimin e rregullores “Për zbatimin e skemës së hemovigjilencës” shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

  
**MINISTRI**  
**ILIR BEQAJ**